




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government

Për :	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Glllogocit Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Glllogocit		
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i MEA-së		
Nga:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare Përgjithshme në MPL		Datë: 05.08.2020
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave  Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave  Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave 		Nr.020-456/7
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glllogocit		
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës		

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendim 12 Nr. 942-22867 për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrale, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.



Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Zivotne Sredine
Ministry of Economy and Environment



Për :	Goran Rakič, Ministër në MAPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Blerim Kuçi, Ministër i MEA Mentor Sylmeta, ud.Sekretar i Përgjithshëm i MEA
Nga:	Florije Kika, Drejtore e Departamentit Ligjor
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Sabrije Rama, Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Minister,
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Rregulloren (QRK) Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm

të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi 12Nr.942-22867 për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrale, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit.
I miratuar me datë: 29.06.2020
I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë:30.06.2020
I dërguar për shqyrtim në MEA, me datë: 02.07.2020
I dërguar për rishqyrtim në MEA, me datë: 22.07.2020

Pas takimit dhe diskutimit me zyrtarët e Komunës së Glllogocit dhe të MEA-së, dhe pas diskutimit dhe sqarimit se me rastin e punimeve ndërtimore, të respektohet distanca prej lumit si parashihet me Ligjin Nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës, paqartësi kjo e cila ishte pasojë e mungesës së një situacioni të kuartë si dhe për shkak se lumi ka qenë i prezantuar me vija të rregullta si dhe shprehjen komasacion, si përfundim Autoriteti Rajonal i Pëllgjeve Lumore, konstatoi se Komuna e Glllogocit, nuk e atakon pronën ujore, andaj si e tillë vlerësimi i ligjshmërisë së Vendimit 12Nr.942-22867 për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrale, miratuar nga Kuvendi i Komunës së Glllogocit nr.prot.3073-2/20, datë 15.07.2020, është i pavlefshëm

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit, pas sqarimit të gjendjes dhe shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr 942-22867 dt. 29.06 2020

Bazuar në nenit 11, 12 dhe 40, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34, pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 9 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rekomandimit Nr. 01-462-20469, të datës 16.06.2020, të Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e mbajtur me datë, **29.06.2020**, miratoj këtë:

V E N D I M

Për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrale

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kërkohet miratimi i bashkimit dhe ndarjes të parcelave kadastrale të cilat janë paraparë që të epen në shfrytëzim sipas procedurave të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Neni 2

Parcelat që kërkohen të bashkohen dhe ndahen, janë si me poshtë:

1. Parcela kadastrale Nr.202-0 zona kadastrale Komoran, propozohet që të bëhet ndarja e parcelës kadastrale me sipërfaqe $S=0.37.00$ ha.
2. Parcela kadastrale 1-5, 1-6, 1-7, propozohet bashkimi i parcelave kadastrale me pjesën e parcelës 1 dhe ndarja e një parcele të re në zonën kadastrale Komoran me sipërfaqe $S=1.12.79$ ha.
3. Parcela kadastrale 4-100 zona kadastrale Komoran, propozohet bashkimi i parcelës me sipërfaqe $S=0.02.00$ ha, dhe të krijohet një parcelë e re me sipërfaqe $S=0.32.66$ ha.
4. Parcela kadastrale 4-85, 4-86, propozohet bashkimi i parcelave kadastrale zona kadastrale Komoran, me sipërfaqe $S=0.20.00$ ha.

5. Parcelat kadastrale 704-0, 705-0, 706-0, 707-0, 708-1, 708-2, 709-0, 710-0 dhe 711-0, propozohet ndarje dhe bashkim i parcelave kadastrale, dhe të krijohet një parcelë e re me sipërfaqe të përafërt $S=1.86.00$ ha zona kadastrale Gllogoc

6. Parcela kadastrale 503-1, 503-2 dhe 502-0, propozohet bashkimi i parcelës zona kadastrale Gllobar, dhe krijimi i një parcele të re me sipërfaqe të përafërt $S=0.68.63$ ha.

7. Parcela kadastrale 150-1, 150-3, zona kadastrale Arllat, propozohet të bëhet bashkimi dhe ndarja e parcelës me sipërfaqe $S=0.43.58$ ha.

Neni 3

Bashkimi dhe ndarja e parcelave kadastrale, bëhet duke pasur parasysh interesin ekonomik të komunës së Drenasit, Planin Zhvillimor Komunal, dhe Planin Rregullues Urban Komunalë.

Neni 4

Për monitorimin dhe zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi 15,ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pasë publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:
-Zyrës së Kryetarit
-Drejtorisë Përkatëse
-Zyrës së Kuvendit
-Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labiror Halilaj